



Australian Government

Department of Home Affairs

Privacy notice

Njoftim rreth fshehtësisë

Form

1442i ALB

ALBANIAN

Departamenti Home Affairs (Departamenti i Çështjeve të Mbrendshme) (Departamenti) tani përfshin edhe Forcën Kufitare Australiane. Sipas *Privacy Act 1988* (Privacy Act) (Kodit të Fshehtësisë 1988 (Kodi i Fshehtësisë)) Departamenti duhet të njoftojë çdo individ rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacioneve personale. Qëllimi i këtij formulari është informimi rreth këtyre çështjeve.

Çfarë quhet informacion personal?

Sipas Kodit të Fshehtësisë, informacione personale quhen ato informacione apo opinione që sjellin identifikimin e një individi.

Departamenti mbledh edhe disa të dhëna të natyrës së veçantë, të cilat klasifikohen në përputhje me Kodin e Fshehtësisë. Të dhënat kanë të bëjnë me racën e një individi, origjinën etnike, orientimin ose praktikën seksuale, krime të kryera në të kaluarën, informacione shëndetësore dhe biometrike, anëtarësi në shoqata profesionale, besimin fetar apo simpatinë për një fe të caktuar, mendimet filozofike dhe anëtarësinë në shoqata politike.

Departamenti administron disa legjislacione kryesore, *Migration Act 1958* (the Migration Act) (Kodi i Emigracionit 1958 (Kodi i Emigracionit)), *Customs Act 1901* (the Customs Act) (Kodi i Doganave 1901 (Kodi i Doganave 1901)), *Immigration (Guardianship of Children) Act 1946* (the IGOC Act), (Kodi i Emigracionit (Kujdestaria e Fëmijëve) 1946 (Kodi IGOC Act)), *Excise Act 1901* (the Excise Act) (Kodi i Akcizës 1901 (Kodi i Akcizës)), *Australian Border Force Act 2015* (the Border Force Act) (Kodi i Forcave Australiane të Mbrojtjes 2015 (Kodi i Forcave të Mbrojtjes)), *Maritime Powers Act 2013* (Maritime Powers Act) (Kodi i Fuqive Detare 2013 (Kodi i Fuqive Detare)), *Australian Citizenship Act 2007* (the Citizenship Act) (Kodi i Nënshetësisë Australiane 2007 (Kodi i Nënshetësisë)).

Të dhënat identifikuese

Kodet e Emigracionit dhe Nënshetësisë përmbajnë rregullore specifike rreth mbledhjes, përdorimit dhe/ose dorëzimit të të dhënave tuaja personale, përfshi këtu edhe të dhënat biometrike (të njohura ndryshe si 'të dhëna identifikuese).

Sipas Kodeve, tregues personalë quhen:

- gjurmët e gishtërinjve ose të duarve
- imazhet e fytyrës dhe të shpatullave
- inçizim audio ose video (me qëllim vetëm përdorimin e parashtruar nga Kodi i Emigracionit dhe me përjashtime të rralla)
- masat e gjatësisë dhe peshës
- skaneri i iridit
- firma e individit
- tregues të tjerë të parashtruar në rregullore.

Të dhënat biometrike (të dhënat identifikuese) mund të mblidhen dhe/ose të identifikohen nga individë:

- në aeroporte gjatë udhëtimeve
- për viza të dorëzuara në Australi (përfshi edhe viza mbrojtëse)
- që nuk janë shtetas brenda komunitetit Australian
- që mbahen në qendrat e mbajtjes së emigrantëve
- që kanë aplikuar për shtetësi Australiane.

Roli i Departamentit dhe të dhënat tona të kontaktit

Misioni i Departamentit është mbrojtja e kufinjve Australianë dhe drejtimi i lëvizjes së njerëzve dhe mallrave nëpërmjet tyre përmes kontributit dhe sigurimit të:

- të ardhmes së Australisë, nëpërmjet drejtimit të procesit të emigracionit
- të mbrojtjes së refugjatëve dhe të japë kontribut në drejtim të proceseve humanitare në rang ndërkombëtar
- mbrojtjes së shtetit Australian nëpërmjet mbrojtjes së kufirit dhe lehtësimit të lëvizjes së udhëtarëve
- mbledhjes së të ardhurave kufitare dhe statistikave tregtare.
- lehtësimit të tregtisë së ligjshme
- sigurisë detare të Australisë dhe interesave të saj tregtare
- përmbajtjes me ligjet e emigracionit Australian dhe të ruajtjes së integritetit në vendim-marrje
- administrimit të ligjeve të nënshetësisë Australiane.

Të dhënat e kontaktit gjenden në faqen e internetit të Departamentit www.homeaffairs.gov.au

Në se mendoni se informacionet tuaja janë mbledhur dhe përdorur në mënyrë të gabuar, ju mund:

- të plotësoni 'online' një formular për shprehjen e komenteve në www.homeaffairs.gov.au/feedback
- të dërgoni një letër në:
The Manager
Global Feedback Unit
GPO Box 241
Melbourne VIC 3001
Australia

Ku e merr Departamenti informacionin tuaj personal

Në përgjithësi Departamenti (ose shërbimet që janë futur në kontratë me të) mbledh informacionin tuaj personal duke e marrë atë drejtpërsëdrejti nga ju, ose nga një palë e tretë e autorizuar nga ju për të vepruar në përputhje me Kodin e Emigracionit. Sistemet e autorizuar përfshijnë 'SmartGate' dhe sisteme të tjera të përdorura nga autoritetet kufitare. Informacionet mund të merren edhe nga palë të treta. Këtu futen agjensi të tjera Qeveritare Australiane, agjensi që kanë të bëjnë me vendosjen e ligjit, qeveri të huaja, sponsorë, mjekë, organizata të nominuara prej jush, shërbime arsimore, punëdhënës dhe persona të thjeshtë që i japin informacione Departamentit (p.sh 'shërbimi i lajmërimit').

Agjensi ose kontraktues që japin shërbime emigracioni

Disa nga informacionet e mbledhura për ne nga agjensi të tjera qeveritare përdoren nga këto agjensi për të kryer funksionet e Departamentit.

Informacionet personale mblidhen dhe përdoren për ne edhe nga kontraktuesit. Këtu futen shembuj të tillë si procedurat e kalimit të pasagjerëve nga linjat ajrore që hyjnë dhe dalin nga Australia, sistemet kompiuterike, intervistat/sondazhet, shërbimet e mbështetjes së personave të mbajtur nëpër qendrat e mbajtjes së emigrantëve dhe shërbimet mjeksore.

Departamenti kërkon që edhe kontraktuesit të jenë të detyruar që të respektojnë Kodin e Fshehtësisë, pavarësisht në se janë të vendosur në Australi ose jashtë saj.

Mbledhja e informacioneve tuaja personale kërkohet ose autorizohet me ligj

Kodi i Emigracionit, Kodi IGOC, Kodi i Doganave, Kodi i Akcizave, Kodi i Fuqive Detare, Kodi i Nënshetësisë dhe Kodi i Fshehtësisë autorizojnë dhe në disa raste i kërkojnë Departamentit që të mbledhë informacione të caktuara personale për qëllimet e zbatimit të këtyre kodeve.

Kodi i Emigracionit

Përsa i përket kërkesave për viza, Departamenti:

- është i autorizuar që të mbledhë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me kërkesat (sipas Nenit 56 të këtij Kodi), dhe
- mund të kërkojë mbledhjen e treguesve personale (sipas Nenit 40 dhe 46 të Kodit të Emigracionit).

Personat që kanë bërë kërkesa për viza dhe disa persona që kanë viza duhet t'a informojnë menjëherë Departamentin në rast se kanë deklaruar informacione të pasakta në një kërkesë apo formular (sipas nenit 104 dhe 105 të Kodit të Emigracionit).

Departamenti mund t'ju kërkojë që të jepni një ose më shumë të dhëna identifikuese në përputhje me Kodin e Emigracionit dhe Rregulloret e Emigracionit 1994.

Kur futeni në Australi, Departamenti ju kërkon që të jepni disa informacione personale (për shembull pasaportën për shtetasit Australiane dhe evidencën e identitetit dhe vizën për shtetasit e huaj). Në se jeni shtetas i huaj dhe këto informacione nuk jepen, atëherë hyrja në Australi refuzohet (sipas Nenit 257A të Kodit të Emigracionit).

Departamenti mund t'ju kërkojë që të jepni tregues personalë kur largoheni nga Australia (sipas Nenit 257A të Kodit të Emigracionit).

Departamenti mund të bëjë kërkesat e mëposhtëme në rast se ka nevojë që të identifikojë personat e paligjshëm:

- prova të identitetit dhe statusit të vizës, duke përfshirë edhe një tregues personal (sipas Nenit 188 të Kodit të Emigracionit)
- t'i kërkojë një personi që të dorëzojë dokumente ose informacione rreth identitetit dhe vendndodhjes së një personi që mendohet se mund të jetë i paligjshëm (sipas Nenit 18 të Kodit të Emigracionit).

Departamenti mund t'i kërkojë personave që mbahen nëpër qendrat e emigracionit që të japin tregues personalë (sipas Nenit 258 dhe 261AA(1) të Kodit të Emigracionit dhe Rregullores 3.30 të Rregulloreve të Emigracionit).

Për sa i përket sponsorëve, Departamenti dhe Fair Work Ombudsman (FWO) (Avokati i Popullit për të Drejtat e Punës (FWO)) mund të mbledhë informacione në përputhje me detyrat e pozitës së inspektorëve të parashtruara në Nën-ndarjen F të Ndarjes 3A të Pjesës 2 të Kodit të Emigracionit.

Si pjesë e fuqive të kontrollit të dhëna nëpërmjet nenit 252 të Kodit të Emigracionit, një oficer i autorizuar mund të mbajë një dokument apo send të marrë drejtpërsëdrejti nga një person ose nga prona e një personi, për shembull për të anuluar vizën që mban ai apo ajo.

Një oficer mund të mbajë një dokument fals (në përputhje me nenin 487ZJ, Pjesa 1, Nën pjesa 9 e Kodit të Emigracionit duke përfshirë këtu edhe mënyrën se si duhet të ruhet ky dokument).

Kodi i Nënshetësisë

Departamenti mund të mbledhë një sërë të dhënash personale për t'u siguruar që një individ i plotëson kriteret për dhënien e nënshetësisë.

Ne jemi të autorizuar që të kërkojmë tregues personalë në lidhje me kërkesat për marrjen e nënshetësisë dhe një kërkesë nuk mund të plotësohet në rast se vendim-marrësi nuk është i bindur në lidhje me identitetin tuaj (sipas Ndarjes 5 të Pjesës 2 dhe Neneve 17(3), 19D(4), 24(3) dhe 30(3) të Kodit të Nënshetësisë).

Një oficer mund të mbajë një dokument fals (në përputhje me nenin 45B, Pjesa 1, Nën pjesa 3 e Kodit të Nënshetësisë duke përfshirë këtu edhe mënyrën se si duhet të ruhet ky dokument).

Kodi IGOC

Në përputhje me *Immigration (Guardianship of Children) Act 1946* (the IGOC Act) (*Kodi i Emigracionit (Kujdestaria e Fëmijëve) 1946* (Kodi IGOC)) dhe rregulloreve të tij, Ministri i Emigracionit është kujdestar i disa fëmijëve të pashoqëruar që mbërrinjnë në Australi pa prindër apo kujdestarë mbi moshën 21 vjeçare (të njohur si fëmijë IGOC).

Për të përmbushur përgjegjësitë e kujdestarisë për këta fëmijë, IGOC i jep Ministrin fuqinë që t'ja delegojë këtë përgjegjësi dhe funksion punonjësve të qeverive të Komonuelthit dhe shteteve e territoreve. Kujdestarë të fëmijëve IGOC mund të bëhen edhe persona apo organizata të përshtatshme. Në përgjithësi, një kujdestar ka të drejtën dhe përgjegjësinë që të marrë vendime rreth kujdesit të përditshëm dhe kontrollit të një fëmije nën kujdestari.

Për të siguruar kujdesin e përditshëm dhe mirëqenien e fëmijëve dhe në përputhje me Kodin IGOC, Departamenti mbledh informacione personale rreth fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre. Për të siguruar kujdesin e përditshëm dhe mirëqenien e fëmijëve të IGOC, sipas nevojës dhe në përputhje me Kodin e Fshehtësisë, Departamenti mund të japë dhe të mbledhë informacione personale nga:

- autoritetet e shteteve /territoreve, duke përfshirë edhe agjensitë e mirëqenies së fëmijëve.
- personat e caktuar si kujdestarë
- mbikqyrësit
- prindërit, kujdestarët dhe/ose të afërmit, dhe/ose
- agjensitë e tjera qeveritare Australiane.

Kodi i Doganave dhe Akcizave

Departamenti ka autorizim që të mbledhë një gamë informacionesh personale dhe rreth bizneseve. Kjo bëhet gjatë administrimit të Kodit të Doganave dhe Akcizës, dhe ligjeve të tjera Australiane (duke përfshirë këtu Kodin e Emigracionit dhe legjislacionin e tatimeve). Në mënyrë të veçantë, Departamenti mbledh informacione me qëllim të mbrojtjes së kufinjve Australianë dhe mbledhjes së të ardhurave nga transaksionet kufitare.

Në disa raste, formularët tanë mbledhin informacione personale që mund të kërkohen në bazë të Kodeve të Doganave dhe Akcizës, legjislacionit të tatimeve dhe kjo bëhet me anë të njoftimeve të caktuara. Këta formularë ju japin informacione specifike rreth mbledhjes, përdorimit dhe dhënies së informacioneve të mbledhura nëpër këto dokumentacione dhe ata duhet të lexohen së bashku me njoftimin rreth fshehtësisë.

Për shembull, në përputhje me nenet 64ACA dhe 64ACB të Kodit të Doganave, Departamenti i kërkohet që të mbledhë informacione personale rreth pasagjerëve dhe ekuipazhit të anijeve dhe avionëve që futen në Australi me qëllim zbatimin e Kodit të Doganave, Kodit të Emigracionit dhe ligjeve të tjera.

Kodi i Fuqive Detare

Departamenti është i autorizuar që të mbledhë informacione personale gjatë zbatimit të ligjeve detare nëpërmjet agjensive të ruajtjes së ujërave. Ky autorizim lejon zbatimin e ligjeve detare Australiane, përfshi peshkimin ilegal, doganat, kundër terrorizmin detar, emigracionin, karantinën, trafikimin e drogës, marrëveshjet ndërkombëtare dhe veprimet në det të hapur.

Kodi i Fshehtësisë

Kodi i Fshehtësisë lejon mbledhjen e:

- informacioneve delikate në përputhje me ligjin ose për qëllime të zbatimit të ligjit ose me lejen tuaj
- informacione të tjera personale që janë të nevojshme ose që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me një ose më shumë funksione dhe aktivitete të Departamentit.

Kodet që emërojnë Departamentin si agjensi të zbatimit të ligjit

Sipas disa akteve, Departamenti është agjensi e zbatimit të ligjit: the *Crimes Act 1914*, the *Criminal Code Act 1995*, the *Australian Nuclear Science and Technology Organisation Act 1987* (the ANSTO Act) and the *Independent National Security Legislation Monitor Act 2010* (Kodit Penal 1914, Kodin e Veprave Penale 1995, Kodin Australian për Organizatat e Shkencës Bërthamore dhe Teknologjisë 1987 (Kodi ANSTO) dhe Kodin Kombëtar të Monitorimit të Pavarur të Legjislacionit për Sigurinë 2010)), dhe si i tillë mund të mbledhë informacione personale për të zbatuar funksionet dhe veprimtarinë e tij në përputhje me këto Kode.

Përse mblidhen informacionet tuaja personale

Qëllimi kryesor pas mbledhjes së informacioneve personale është kryerja e funksioneve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me emigrimin tuaj, me marrjen e nënshtetësisë apo lëvizjen e mallrave nëpër kufi. Ne drejtojmë programet e mëposhtme:

- vizat dhe emigracionin
- doganat dhe akcizat, përfshi zbatimin e disa ligjeve Australiane si tatimet, shëndetësinë, karantinën, tregtinë, krimet, pronat intelektuale dhe ligjet për mbrojtjen e komunitetit
- ndihmat humanitare dhe për refugjatë
- drejtimin e proceseve të kufirit
- respektimin e kushteve të vizave dhe zgjidhjen e statusit të emigracionit
- mbajtjen në qendrat e mbajtjes së refugjatëve, mbërritjen dhe transfertat në Qendrën e Procedurave Rajonale (duke përfshirë shërbimet apo autoritetet e huaja që merren me procedurat e shqyrtimit jashtë vendit, zbatimin e ligjit, shërbimet e mirëqenies dhe vendosjes)
- nënshtetësitë.

Informacionet që jepni ju në një kërkesë për vizë, në tregti, import, eksport, karantinë ose sponsorizim dhe nënshtetësi, do të përdoren vetëm për këtë qëllim.

Sipas Kodit të Fshehtësisë, informacioni mund të përdoret edhe për qëllime të dyta. Në këto raste Departamenti e përdor ose e jep këtë informacion për qëllime që kanë të bëjnë me qëllimin primar të marrjes së këtij informacioni (për informacione delikate) ose kanë lidhje me qëllimin kryesor (për informacione të tjera.). Për shembull, informacionet që keni dhënë në një kërkesë për vizë mund të përdoren për kërkesa të tjera që mund të bëni (*Freedom of Information Act 1982* (Kodit të Lirisë së Informacionit 1982) dhe Kodit të Fshehtësisë). Më vonë ne mund të përdorim edhe të dhënat tuaja elektronike për t'ju kontaktuar rreth çështjeve tuaja të emigracionit.

Pasojat e mundshme në rast se Departamenti nuk është në gjendje që të mbledhë informacionet tuaja personale

Në se informacionet tuaja personale nuk merren, Departamenti nuk do të jetë në gjendje që të vendosë rreth kërkesës suaj për vizë apo nënshtetësi ose (në se është e nevojshme) rreth shërbimeve të nevojshme të tregtisë, importit, eksportit dhe karantinës si edhe ndihmës për ju.

Mungesa e informacioneve rreth jush mund të kufizojë aftësinë e Departamentit që të plotësojë detyrimet e tij (sidomos në lidhje me mbrojtjen), detyrat rreth drejtimit të proceseve të emigracionit dhe detyrimet e shtetit Australian në rang ndërkombëtar.

Dhënia rutinë e informacioneve tuaja tek palët e treta

Dhënia e informacioneve tek personat e autorizuar

Informacionet tuaja mund t'i jepen palëve të treta si për shembull një anëtar të familjes, një agjenti të emigacionit, të doganave, agjenti turistik ose përfaqësues të linjave ajrore, Avokatit të Popullit, Deputeti ose një avokati. Përjashtime përbëjnë vetëm ato raste kur ju na autorizoni që të mos e bëjmë një gjë të tillë.

Informacionet tuaja personale mund t'i jepen edhe një personi që sponsorizohet prej jush ose që ju sponsorizon ju.

Dhënia rutinë e informacioneve tuaja tek Agjensitë Qeveritare

Për më tepër, Departamenti në disa raste ka të drejtë ose është i autorizuar nga Kodi i Forcave Kufitare dhe legjislacione të tjera që t'i japë informacionet tuaja personale agjensive të tjera të cilat mund t'i përdorin ato në procesin e administrimit të funksioneve dhe aktiviteteve dhe funksioneve të tyre. Për shembull informacionet mund të jenë në ato raste kur është e nevojshme që të vërtetohet identiteti juaj apo vërtetësia e dokumenteve që keni dhënë, gjatë procesit të vërtetimit të të dhënave dhe përmbushjen e detyrimeve të caktuara në mbrojtje.

Ne shkëmbejmë informacione me agjensitë e mëposhtme qeveritare dhe të tjera:

- Departamenti i Shërbimeve Civile (DHS) që administron *Social Security Act 1991* (Kodin e Sigurimeve Sociale 1991), *Child Support (Assessment) Act 1989* (Kodin e (Caktimit) të Pagesave Ushqimore për Fëmijë 1989)) dhe *Child Support (Registration and Collection) Act 1988* (Kodin e (Regjistrimit dhe Mbledhjes) së Pagesave Ushqimore për Fëmijë 1988)
- Departamenti i Shërbimeve Sociale
- Departamenti i Bujqësisë, që merret me ruajtjen dhe zbatimin e sistemeve të biosigurisë sipas *Quarantine Act 1908* (Kodit të Karantinës 1908), *Export Control Act 1982* (Kodit për Kontrollin e Eksporteve 1982) dhe *Imported Food Control Act 1992* (Kodit të Kontrollit të Ushqimeve të Importuara 1992)
- Administrimi i Mallrave për Terapi
- Departamenti i Industrisë, Inovacionit dhe Shkencës
- Australian Sports Anti-Doping Authority (Autoriteti Australian për Anti-Doping në Sport) me qëllim administrimin e National Anti-Doping Scheme (Skemës Kombëtare Anti-Doping)
- Departamenti i Arsimit që administron Shërbimet për *Education Services for Overseas Students Act 2000* (Kodit për Shërbimet e Arsimit për Studentët e Huaj 2000)
- Departamenti i Punësimit, Aftësive, Bizneseve të Vogla dhe Familjare, për të verifikuar informacione rreth shërbimeve të punësimit
- Departamenti i Shërbimeve për Veteranë që administron *Veterans' Entitlements Act 1986* (Kodin e të Drejtave të Veteranëve 1986)
- Zyra Australiane e Tatimeve (ATO), që administron *Income Tax Assessment Act 1997* (Kodin për Caktimet e Tatimeve mbi të Ardhurat 1997)
- Avokatit të Popullit për Punësimin (FWO) i cili administron *Fair Work Act 2009* (Kodin e Punës 2009)
- Departamenti i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë (DFAT), që administron *Australian Passport Act 2005* (Kodin e Pasaportave Australiane 2005) dhe për të marrë informacione rreth vendeve të ndryshme për qëllimet e procedurave të vizave dhe në lidhje me pasaportat e huaja që mund të keni të drejtë të mbani në se jeni person me dy shtetësi
- Komisioni Australian i Zgjedhjeve që administron *Commonwealth Electoral Act 1918* (Kodin e Komonuelthit për Zgjedhjet 1918).

Organet e Rishikimit, Kontrollit dhe Hetimeve

Në se bëni kërkesë për apelim pranë gjykatave të niveleve të ndryshme, Departamenti do t'ja japë informacionet tuaja edhe gjykatës përkatëse që do të merret me apelimin.

Informacionet i jepen edhe organeve hetuese si për shembull:

- Avokatit të Popullit në rang Komonuelthi
- Zyrës së Komisionerit Australian për Informacionin
- Zyrës së Kontrollit të Shtetit Australian
- Komisionit Australian të të Drejtave të Njeriut
- Avokatit të Popullit për të Drejtat e Punës.

Organet e Zbatimit të Ligjit dhe Shërbimet e Urgjencave

Të dhënat tuaja personale të kontaktit mund t'i jepen edhe agjensive të zbatimit të ligjit apo shërbimeve të urgjencës në rast urgjence, lëndimi serioz ose vdekjeje.

Departamenti u jep informacione edhe agjensive të zbatimit të ligjit Australian (në rang Komonuelthi, shteti dhe territori), agjensive të huaja ose organeve të tjera kur është e nevojshme për qëllimet e zbatimit të ligjit, parandalimit, zbulimit dhe ndjekjes penale apo ndërshkimit të një vepre penale.

Programet e ndihmës

Informacionet e mblledhura gjatë procesit të shqyrtimit të vizave u jepen:

- Departamentit të Shërbimeve Sociale për të dhënë ndihmë për emigrantët në vendosjen në Australi
- Departamentit të Industrisë, Inovacionit dhe Shkencës për të lehtësuar dhe monitoruar trajnimin e gjuhës Angleze

Informacione për autoritetet liçensuese

Në se bëni kërkesë për liçensë në Australi, Departamenti mund t'i japë autoriteteve përkatëse informacione në lidhje me statusin tuaj të emigracionit, lejen e punës dhe në disa raste edhe në se keni nënshtetësi Australiane ose jo. Ky informacion përdoret për të shqyrtuar në se keni të drejtë që të mbani liçensë. Në se bëni kërkesë për një liçensë të caktuar, mund t'ju duhet të jepni më shumë informacione.

Dhënia e autorizuar e informacioneve personale

'Tregues personal' përkufizohet në Faqen 1.

Departamenti ka të drejtë që në përputhje me Pjesën 4A të Kodit të Emigracionit dhe Nenit 43 të Kodit të Nënshitetësisë, të japë informacionet tuaj gjatë një numri të caktuar rrethanash. Për shembull:

- për të vërtetuar statusin e nënshtetësisë dhe vizave
- për zbatimin e kodit penal
- për shkëmbimin e informacioneve personale sipas një marrëveshjeje me një agjensi qeveritare Australiane
- dhënien e informacioneve të kërkuara, një organi gjyqësor ose hetimor
- në përputhje me ligjet Australiane.

Departamenti ka gjithashtu të drejtë që të japë informacione personale në përputhje me Kodin e Nënshitetësisë për qëllime të legjislacionit të nënshtetësisë dhe emigracionit.

Pjesa 4A e Kodit të Emigracionit autorizon Departamentin që të japë informacione personale (duke përfshirë këtu edhe tregues personalë) në rrethanat e mëposhtme:

- vërtetimin e të dhënave për:
 - identifikimin ose vërtetimin e identitetit të një personi
 - lehtësimin e procedurave të hyrjes dhe daljes së një personi nga Australia
 - identifikimin e një jo-shtetasi i cili ka një të kaluar kriminale, që është i dyshuar për një vepër të caktuar ose përbën shqetësim në lidhje me sigurinë kombëtare
 - luftën kundër dokumenteve dhe identiteteve false në çështjet e emigracionit
 - për ndihmë në lidhje me procedurat e shqyrtimit të vizave mbrojtëse
- për të identifikuar një person ose për të gjetur vendndodhjen e tij (shih edhe Nenin 33FA dhe 33FC të Kodit të Emigracionit)
- për organe të caktuara hetimore si Zyra Australiane e Kontrollit Kombëtar dhe Komisioni Australian për të Drejtat e Njeriut
- për të marrë masat e nevojshme me qeveritë e huaja për të larguar një person të caktuar nga Australia ose për t'a sjellë atë aty
- për t'i dhënë informacionet e nevojshme qeverive të huaja, organeve të ligjit dhe ruajtjes së kufirit ose organizatave të caktuara ndërkombëtare për qëllimet e drejtimit të çështjeve të emigracionit (shih Nenin 5A(3) të Kodit të Emigracionit)
- për marrjen dhe dhënien e ndihmës në rastet penale në rang ndërkombëtar.

Për më shumë informacion rreth treguesve personalë, shih Formularin 1243i.

Në lidhje me vizat e punëtorëve, Departamenti është i autorizuar që të japë informacione personale për sponsorët dhe vizë-mbajtësit tek vizë-mbajtësit dhe sponsorët përkatësisht (shih Nenin 140ZH të Kodit të Emigracionit dhe Rregulloreve 2.103, 2.104 dhe 2.105).

Departamenti është i autorizuar që të japë informacione personale që janë informacione të Emigracionit dhe Mbrojtjes Kufitare (shikoni seksionin 4(1) të Aktit të Forcave Kufitare) në rrethana të kufizuara, të përshkruara në Pjesën 6 të Aktit të Forcave Kufitare. Në raste të caktuara, Akti i Forcave Kufitare lejon nxjerrjen e informacioneve për organet e mëposhtme:

- Agjensitë dhe autoritetet e Komonuelthit, shteteve dhe territoreve
- Policia Federale Australiane (AFP) ose forcat dhe shërbimet policore të shteteve dhe territoreve
- Hetuesit
- Organet e mbikqyrjes së zbatimit të ligjit në rang Komonuelthi, shteti apo territori (p.sh avokati i popullit)
- Organet ose personat e parashtruar nga Forcat Kufitare Australiane (Secrecy and Disclosure) (Sekrete dhe Dhënie Sekrete) – Rregullorja 2015, si edhe Shoqata Australiane e Kryqit të Kuq
- Shtete të huaja ose organizata publike ndërkombëtare.

Megjithatë, përveç kriterëve specifike të Ndarjes 6 të Kodit të Forcave Kufitare, dhënia e informacioneve personale në përputhje me Kodin e Forcave Kufitare autorizohet vetëm në ato raste kur përputhet me një apo më shumë nga 'rrethanat' e mëposhtme të paracaktuara nga Kodi i Forcave Kufitare. Disa nga shembujt përfshijnë rrethanat e:

- zbatimit të ligjeve penale dhe atyre tregtare
- hetimeve, zbardhjes së rrethanave të një ngjarjeje
- mbrojtjes së shëndetit publik, jetës dhe sigurisë së një apo më shumë personave
- mblledhjes ose verifikimit të statistikave në përputhje me *Census and Statistics Act 1905 (Kodit të Regjistrimit të Popullsisë dhe Statistikave 1905)* ose *Australian Bureau of Statistics Act 1975 (Kodit të Byrosë Australiane të Statistikave 1975)*
- mbrojtjes së të ardhurave publike
- identifikimit të një personi ose verifikimit të shtetësisë ose statusit të vizës së tyre.
- shërbimit për persona që nuk janë shtetas Australianë
- zbatimin e Skemës Kombëtare Anti-Doping
- çështje që kanë të bëjnë me emigracionin, karantinën ose kontrollin e kufirit mes Australisë dhe një shteti tjetër.
- çështje të ruajtura nga një numër legjislacionesh si Customs Act, Migration Act, Maritime Powers Act, Citizenship Act, IGO Act, (Kodi i Doganave, Kodi i Emigracionit, Kodi i Fuqive Detare, Kodi i Nënshitetësisë, Kodi IGO Act)
- me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Departamenti është i autorizuar që të japë informacione personale në rast se individit jep leje për dhënien e tyre, në se dhënia e tyre është e nevojshme për të parandaluar apo pakësuar kërcënimin për jetën ose shëndetin e një individi ose në se informacioni është bërë publik më parë në përputhje me ligjin.

Neni 51 i Kodit të Forcave Kufitare përcakton që informacionet të jepen në përputhje me disa pjesë të Ndarjes 6 të këtij Kodi dhe në se një gjë e tillë autorizohet nga ky Kod, ajo duhet të bëhet në përputhje me Kodin e Fshehtësisë.

Po ashtu, dhënia e informacioneve nga Akti i Forcave Kufitare lejohet në rast se bëhet gjatë detyrës ose shërbimit të një personi të besuar të Departamentit. Departamenti ka për detyrë që të sigurohet që raste të tilla bëhen në përputhje me Aktin e Fshehtësisë.

Departamenti është i autorizuar që të japë edhe ato informacione që janë të mbrojtura me ligj. Kjo bëhet në rrethana të kufizuara dhe në përputhje me legjislacione të tilla si Kodi i Doganave dhe rregullore të tjera.

Dhënia e Protokollit të Lëvizjeve

Protokollet e mbërritjes dhe nisjes së udhëtarëve për dhe nga Australia të cilat mbahen në bazën e të dhënave. Këto të dhëna mund të jepen kur:

- zbatohet Kodi i Emigracionit
- zbatohet *Family Law Act 1975 (Kodi i Familjes 1975)*
- zbatohen ligjet e doganave ose akçizës
- zbatohen ligjet e karantinës dhe të shëndetësisë
- zbatohet ligji
- *Education Services for Overseas Students Act 2000 (Shërbimet e Arsimit për Studentët e Huaj 2000)*
- zbatohen legjislacionet e Komonuelthit, shteteve dhe territoreve si për shembull administrimi i programit të pronarëve të shtëpive për herë të parë ose programet e fëmijëve dhe të mirëqenies për fëmijë.

Dhënia e informacioneve për zbatimin e ligjit

Dhënia e informacioneve nga Departamenti me qëllim zbatimin e ligjeve (përfshi aktivitetet në përputhje me Kodet e Emigracionit dhe Nënshetësisë dhe aktivitetet e agjensive të tjera të zbatimit të ligjeve) përfshijnë:

- agjensitë e zbatimit të ligjit brenda dhe jashtë Australisë të cilat kanë për detyrë që të kryejnë verifikimet e gjendjes penale
- agjensitë e zbatimit të ligjit brenda dhe jashtë Australisë ose komisionet, Shërbimet Kombëtare të Policisë, Interpoli, Qendra Kombëtare e Mbrojtjes së Kufirit, CrimTrac, AusTRAC, komisionet e zbatimit të ligjit, komisionet parlamentare, gjykatat ndërkombe dhe autoritetet jashtë vendit që merren me identifikimin dhe hetimin e rasteve të fallsifikimeve, sigurisë kombëtare ose pjesëmarrjes në krimet luftës ose atyre ndaj njerëzimit
- Komisionit Australian për Integritetin e Zbatimit të Ligjeve në përputhje me *Law Enforcement Integrity Commissioner Act 2006 (Kodin e Komisionerit të Integritetit për Zbatimin e Ligjeve 2006)*
- ATO, DHS, Centrelink dhe agjensi të tjera në nivel Komonuelthi, shtetesh apo territorësh për kërkimin dhe gjetjen e atyre personave që thyejnë kushtet e vizave të punës.
- AFP, dhe forcat e policisë Australiane për të gjetur shtetas me status të paligjshëm
- drejtorin e Prokurorisë i cili merret me shkeljet e Kodit të Emigracionit dhe Nënshetësisë
- qeveritë e vendeve të tjera me qëllim heqjen e personave të paligjshëm
- FWO, institucione të regjistruara fetare, punëdhënës, persona të sponsorizuar, sponsorë dhe shërbimet e krahut të punës për të monitoruar respektimin e kushteve të vizave dhe detyrimet e parashtruara për sponsorizimet si edhe njoftimin e dënimeve të mundshme
- Agjensitë e zbatimit të ligjit, duke përfshirë AFP dhe në lidhje me të dhënat personale të personave që kanë aplikuar për viza dhe propozimeve në bazë të programit për Refugjatë dhe Humanizëm si dhe për identifikimin e ndonjë rreziku ndaj zbatimit të ligjit dhe sigurisë kombëtare.

Dhënia e informacioneve nga Departamenti si pjesë e funksioneve të zbatimit të ligjit.

Sipas disa akteve, Departamenti është agjensi e zbatimit të ligjit: the *Crimes Act 1914*, the *Criminal Code Act 1995*, the *Australian Nuclear Science and Technology Organisation Act 1987* (the ANSTO Act) and the *Independent National Security Legislation Monitor Act 2010* (Kodit Penal 1914, Kodin e Veprave Penale 1995, Kodin Australian për Organizatat e Shkencës Bërthamore dhe Teknologjisë 1987 (Kodi ANSTO) dhe Kodin Kombëtar të Monitorimit të Pavarur të Legjislacionit për Sigurinë 2010)), dhe mund të japë informacione si pjesë të detyrave dhe funksioneve të tij në përputhje me këto kode.

Dhënie të tjera informacionesh që kanë të bëjnë me drejtimin e programeve

Siguracion financiar

Informacione të veçanta që kanë të bëjnë me dhënien e Siguracioneve Financiare do t'i jepen Centrelink për të mundësuar procesin e depozitave të paguara dhe identifikimin e borxheve të mundshme brenda të njëjtës dispozitë.

Punësimi, marrja e krahut të punës dhe aftësitë e biznesit

Informacione rreth të drejtave tuaja për të punuar, vizës dhe kohëzgjatjes së saj mund t'i jepen edhe punëdhënësve, shërbimeve që sigurojnë krahn e punës dhe palëve të treta që mund të përdorin shërbimet tuaja. Për shembull, kur bëni kërkesë për punë, Departamenti mund t'i japë punëdhënësit informacion rreth mundësive që keni për të punuar.

Informacione mund t'i jepen edhe departamenteve të zhvillimit ekonomik dhe agjensive që ndihmojnë emigrantët që kanë emigruar në sajë të aftësive në biznes që të marrin informacionet e duhura nga qeveritë.

Trajnimi dhe Arsimi

Informacionet personale mund t'i jepen edhe:

- DFAT, Departamentit të Industrisë, Departamentit të Arsimit për t'i ardhur në ndihmë atyre personave që kanë dëshirë që të trajnohen apo të studiojnë në Australi
- Departamentit të Punësimit për të caktuar ndikimin që mund të ketë një propozim rreth marrëdhënieve të punës mbi tregun Australian të punës
- Departamentit të Arsimit dhe autoriteteve që merren me vlerësimin e kualifikimeve të nevojshme për disa klasa vizash
- institucione arsimore që meren dhe dhënien e mësimave të gjuhës Angleze sipas Programit të Mësimin të Gjuhës Angleze për të Rritur
- Autoritetin për Cilësinë e Kualifikimeve Australiane me qëllim monitorimin e organizatave të regjistruara të trajnimit.

Shëndetësia

Të dhënat shëndetësore të anëtarëve tuaj të familjes të dala nga ekzaminimet mjeksorë të kryera si pjesë e kërkesës për vizë mund t'i jepen agjensive shëndetësore qeveritare dhe shërbimeve mjeksore në mënyrë që ato të vendosin në se kriteret shëndetësore për dhënien e një vize plotësohen dhe në se është e drejtë që ato të injorohen ose për mbajtjen nën kontroll të rreziqeve të shëndetit publik.

Personat që hyjnë në Mënyrë Humanitare dhe Kërkesat për Mbrojtje të bëra Brenda Australisë

Departamenti mund të japë informacionet e personave që hyjnë në Australi si refugjatë apo në mënyrë humanitare tek shërbimet e marra me kontratë nga Departamenti për të dhënë Ndihmën Humanitare për Vendosje.

Departamenti mund të japë informacionet e personave që hyjnë në Australi si refugjatë apo si azil kërkues dhe kërkesat për mbrojtje ose ndihmë humanitare tek Komisioneri i Lartë për Refugjatë Pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KLROKB) për verifikimin e të gjitha provave të dhëna në drejtim të identifikimit dhe nevojës për mbrojtje dhe ndihmë humanitare.

Departamenti mund t'i japë informacionet tuaja edhe Organizatës Ndërkombëtare për Emigracion për t'i ardhur asaj në ndihmë me shërbimet që jep ajo.

Qendrat e ndalimit

Informacionet rreth personave në qendrat e ndalimit mund t'i jepen:

- agjensive të ndihmës për shtetet dhe territorët rreth masave të marra në qendrat e ndalimit, kujdesit për personat e pashoqëruar dhe nën moshë ose kujdestarinë për personat me paaftësi fizike dhe mendore

- shërbimeve të ndërkombëtit në shtete dhe territore me qëllim transferimin dhe konfirmimin e statusit të emigracionit
- shërbimet e shqyrtimit të kërkesave jashtë vendit
- shkollave, mjekëve, shërbimeve mjeksore dhe të mirëqenies, këshilluesve për emigracionin që kanë për qëllim që t'ju shërbejnë ju ose që t'ju ndihmojnë ju dhe familjen tuaj që të largoheni nga Australia.

Mirëqenia dhe mbrojtja e fëmijëve

Të dhënat personale të fëmijëve dhe/ose të prindërve/kujdestarëve të tyre mund t'i jepen agjensive të mbrojtjes së fëmijëve, të mirëqenies së fëmijëve në shtete/territore, policisë në shtete/territore dhe agjensive të tjera qeveritare, për të:

- Organizuar dhe monitoruar kujdesin dhe mirëqenien e tyre në qendrat e mbajtjes ose në komunitet
- Hetuar abuzimet apo neglizhencat e mundshme
- Mundësuar udhëtimet dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Informacione që kanë të bëjnë me ata fëmijë që futen në Australi si të adoptuar mund t'i çohen organizatave të mirëqenies nëpër shtete dhe territore, Autoriteteve Qëndrore Australiane për Adoptimet brenda dhe jashtë Australisë.

Informacionet që u jepen ambasadave, komisioneve të larta dhe konsullatave për marrjen e dokumenteve të udhëtimit

Në se ju jepet një vizë mbi bazën e qëllimit për t'u larguar nga Australia, atëherë ju duhet të largoheni. Në se nuk keni dokument udhëtimit, atëherë Departamenti bën kërkesë në emrin tuaj. Kjo më pas lejon edhe marrjen e masave për largimin tuaj nga Australia.

Departamenti do të japë vetëm informacionet e nevojshme që kërkohen nga ambasada, komisioni i lartë apo konsullata përkatëse. Në këto informacione futet emri dhe mbiemri juaj, detajet e pasaportës dhe dokumentë të tjerë indentiteti së bashku me të dhënat e kontaktit.

Nënshtetësia

Departamenti mund të japë informacionet tuaja personale së bashku me treguesit personalë në bazë të kërkesës nga:

- Qeveritë lokale dhe organizata të tjera për qëllimet e mbajtjes dhe organizimit të ceremonive të marrjes së nënshtetësisë
- zyrës së Sekretarit të Guvernatorit të Përgjithshëm dhe Departamentit të Kryeministrit dhe Kabinetit për rastet e dhënies së çmimeve të nderit
- Anëtarëve të Parlamentit dhe këshilltarëve të qeverive lokale për qëllimet e mirëpritjes së shtetasve të rinj në komunitetin Australian.

Studimet rreth Emigracionit

Informacionet personale mund t'i jepen klientëve të kaluar apo të tashëm për qëllime sondazhesh. Informacionet personale mund t'i jepen agjensive të tjera dhe palëve të treta që veprojnë nën kontratë për qëllimet e studimeve, hetimeve dhe analizave që kanë për qëllim krijimin e rregulloreve dhe programeve. Sipas kontratave përdorimi i të dhënave është i kufizuar dhe ato eliminohen në mbarim të studimit. Të dhënat e mbledhura manipulohen për të hequr mundësitë e identifikimit.

Informacionet personale mund t'i jepen edhe Byrosë Australiane të Statistikave për t'i ardhur në ndihmë studimeve demografike rreth emigrantëve të sapo ardhur, analizën e programeve të ndryshme për emigrantë dhe vlerësimin e efikasitetit të tyre.

Informacionet rreth emigrantëve të sapo ardhur mund t'i jepen edhe agjensive të shteteve dhe territoreve ose organizatave të shërbimeve për emigrantë për qëllimet e planifikimit të shërbimeve të nevojshme.

Evenimente në shkallë ndërkombëtare

Informacionet personale mund t'i jepen edhe Agjensive qeveritare Australiane, duke përfshirë këtu agjensitë e shteteve dhe territoreve që luajnë rol në koordinimin e evenimenteve ndërkombëtare si për shembull: ndeshjet dhe lojrat sportive, takimet diplomatike mes vendeve të ndryshme, festival dhe mitingje sociale, kulturore dhe fetare në nivel botëror.

Departamenti mund t'ja japë informacionet tuaja edhe organizatave Australiane dhe ndërkombëtare si edhe vendeve të tjera për të ndihmuar me masat e nevojshme.

Informacione rreth rregulloreve të Departamentit për fshehtësinë

Rregullorja e Departamentit rreth fshehtësisë mund të merret nga faqja e internetit <https://www.homeaffairs.gov.au/access-and-accountability/our-commitments/privacy> ose cilëso nga zyrat e Departamentit.

Kjo rregullore përmban informacione rreth:

- si mund të merrni kopje të informacioneve që ka për ju Departamenti dhe se si mund t'i korrigjoni ato
- si mund të ankoheni rreth prekjes së rregullave të fshehtësisë si edhe rreth procedurave të Departamentit rreth këtyre ankesave.

Dhënien e informacioneve tuaja personale tek palët jashtë vendit

Departamenti përdor kontraktues të jashtëm IT për të transmetuar, ruajtur të dhëna duke përfshirë këtu edhe shërbime të vendosura jashtë vendit.

Në disa raste, informacionet personale u jepen edhe palëve të vendosura jashtë vendit. Shpesh palë të tilla janë autoritetet e vendit ku ju jetoni zakonisht apo nga jeni nisur (përveç rasteve kur keni bërë kërkesë për status mbrojtjeje nga këto vende dhe prisni vendimin për kërkesën tuaj). Këtu futen edhe linjat ajrore, agjentët e udhëtimit në lidhje me procedurat e pasagjerëve dhe të vizave elektronike.

Departamenti shkëmben informacione me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që kanë marrëveshje të shkëmbimit dypalësh me Australinë. Këtu përfshihen Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja dhe Zelanda e Re. Shkëmbimet e informacionit mund të përfshijnë treguesit biometrikë.

Në se treguesit tuaj personalë përputhen, Departamenti mund t'ja japë të dhënat tuaja, kopje të dokumenteve të udhëtimit, të identitetit ose informacione nga këto dokumente, statusin tuaj të emigracionit, historikun tuaj të emigracionit (ku mund të hyjnë edhe shkeljet e ligjeve të emigracionit) dhe informacione të tjera të karakterit penal.

Qëllimi i dhënies së informacioneve është verifikimi i identitetit tuaj dhe vërtetimi i këtij identiteti me agjensitë.

Në se keni bërë kërkesë për vizë mbrojtëse ose humanitare që nga jashtë Australisë mbi bazë të fakteve që tregojnë se persekutoheni nga qeveria e një shteti të caktuar, Departamenti nuk do t'ja japë të dhënat tuaja asaj qeverie, përveç atyre rasteve kur ndodheni në Australi dhe:

- Keni kërkuar që të ktheheni në vendin tuaj, ose
- Kërkesa juaj refuzohet për shkak se ju nuk quheni si person që ka nevojë për mbrojtje nga Australia.

Faqja e internetit **www.homeaffairs.gov.au**

*Linja e
përgjithshme e
informacioneve
telefonike*

Telefoni **131 881** gjatë orëve të punës në Australi bisedoni me një operator (jashtë këtyre orëve kemi informacione të inçizuara). Në se gjendeni jashtë Australisë ju duhet t'i drejtoheni misionit më të afërm diplomatik.